



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:174568
Datë: 02.05.2024
Numri i dokumentit: 05647327

KE.nr. 153/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen juridike të Paditësit/Kundërtëpaditurit XH.G. nga fshati ..., Komuna e Glllogocit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Gazmend Halilaj, avokat nga Glllogoci, ndaj të Paditurve/Kundërpaditësve B.Xh. dhe XH.XH., që të dy nga fshati ... Komuna e Glllogocit, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Valon Jupa, avokat nga Prishtina, me objekt kontesti kthimi i borxhit, pas shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seancës me datën 02.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Glllogoc, për të vendosur në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së Paditësit/Kundërtëpaditurit XH.G. dhe kundërpadisë së të Paditurve/Kundërpaditësve B.Xh. dhe XH.XH., me objekt kontesti kthimi i borxhit.
- II. Për të vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar me datë 14.09.2018, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega Glllogoc, ka paraqitur padi ndaj të paditurve B.Xh. dhe XH.XH., me të cilën ka kërkuar që të detyrohen të paditurit që paditësit t'ia kthejnë borxhin.

Në të njejtën procedurë, të paditurit kanë paraqitur kundërpadi me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet Paditësi/Kundëripadituri që të Paditurve/Kundërpaditësve t'ia kthej borxhin e mbetur.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega Glllogoc, me AKtvendiminC.nr. 310/18, të datës 19.01.2024, është shpallur jokompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje kontestimore, ndërsa lëndën e ka dërguar pranë Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike.

Kjo gjykatë, pas shqyrtimit paraprak të shkresave të lëndës, në përputhje me nenin 17 dhe 19 të LPK-së, vlerësoi kompetencën lëndore në këtë çështje juridike dhe gjeti se Departamenti për Çështje Ekonomike pranë Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për trajtimin e kësaj çështje kontestimore.

Sipas nenit 13, pika 1.1 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, me të cilin është përcaktuar se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*. Nisur nga kjo dispozitë, rezulton se Gjykata Komerciale ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë, në kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridik publik dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështjet tjera mes tyre.

Andaj, meqë në rastin konkret në palët ndërgjyqëse janë personat fizik, ndërsa Departamenti për Çështje Ekonomike në kuadër të Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale është kompetent për të vendosur kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridik publik dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre, rezulton se kjo çështje nuk bie në kompetencë lëndore të kësaj gjykate.

Ndërsa, duke u bazuar në nenin 12 dhe 20 të Ligjit për Gjykata (Ligji nr. 06/L-054), lidhur me nenin 37 dhe 38 të LPK-së, kjo gjykatë vlerëson se kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është pikërisht Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega Glllogoc.

Nga sa u tha më lartë, në mbështetje të dispozitave nga neni 24 dhe 25.2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 153/24, datë 02.05.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.